



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo za Financije - Ministry of Finance

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS  
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA  
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

# Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit

## Dhjetor 2021

**Prishtinë, 11.01.2022:** Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka filluar të publikojë Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) në shtator të vitit 2002 deri në muajin dhjetor 2015, ndërsa nga muaji janar 2016 është harmonizuar sipas konceptit ndërkombëtar dhe publikohet si Indeks i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK). Çmimet e konsumit kanë filluar të mblidhen në muajin maj të vitit 2002 i cili konsiderohet muaji bazë. Nga muaj janar i vitit 2016 Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) bazuar në rekomandimet e Eurostatit publikohet me vitin bazë 2015=100 dhe janë rillogaritur mbi këtë bazë të gjitha seritë kohore të Indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) përkatësisht Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) në vend dhe janë të publikuara në Ueb-faqen e ASK-ës (në publikimin vjetor të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit 2002 - 2020). Çmimet konsumit mblidhen prej datës 10 deri 20 të muajit në 14 Komuna të Kosovës. ASK nga muaji shtator i vitit 2002 në vazhdimësi ka publikuar në baza mujore IÇK - IHÇK dhe shtatëmbëdhjetë publikime në baza vjetore (2004 - 2020).

Ky publikim përmban tabelën me Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në Kosovë në baza mujore janar 2010 - dhjetor 2021, mesatarja vjetore 2010-2021 (2015=100), me ndryshimet mujore dhe vjetore në përqindje, paraqitja grafike, tabelën për peshat specifike, indeksin për muajin dhjetor 2021, ndryshimet mujore dhe vjetore të indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit në përqindje (Dhjetor 2021 / Nëntor 2021) dhe (Dhjetor 2021 / Dhjetor 2020) dhe ndryshimet vjetore të indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit në përqindje (Viti 2021 / Viti 2020) për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it, tabelën me çmime mesatare për disa artikuj të konsumit dhe metodologjinë e llogaritjes së indekseve të harmonizuara të çmimeve të konsumit.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dërgoni në adresën e ueb [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)

Ky publikim është përgatitur nga:

Ismajl Sahiti - Zv. Drejtor i Departamentit

Ibish Asllani - Shef i Divizionit

Raif Gashi - Zyrtar i lartë

Saranda Berisha - Zyrtare

Janar, 2022

Zv. Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-ës  
Ilir T. Berisha

Për t'u konsultuar me publikime të tjera, vizitoni faqen e ASK: <http://ask.rks-gov.net>

---

**Simbolet dhe Shkurtesat**

IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
COICOP	Klasifikimi i konsumit individual sipas qëllimit
ABF	Anketa e buxhetit familjar
LLK	Llogaritë Kombëtare
IHÇK	Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
:	Shifra nuk është disponibël
0	Më pak se gjysma e njësisë së përdorur
-	Nuk aplikohet
%	Përqindje
‰	Promil
W	Ponderët statistikor (pesha specifike – IÇK/IHÇK)
Ø	Mesatare

**Përmbajtja**

	Faqe
Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për muajin Dhjetor 2021 .....	4
Tab. 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 - Dhjetor 2021 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje .....	6
Graf. 1: Indeksi i harmonizuar vjetor i çmimeve të konsumit sipas viteve 2010 - 2021 (2015=100).....	9
Graf. 2: Normat vjetore dhe mujore të inflacionit në përqindje të matura nga IHÇK-it.....	9
Tab. 2: Peshat, IHÇK-it për muajin Dhjetor 2021 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it .....	10
Tab. 3: Çmimi mesatar në euro për disa artikuj dhe shërbime të konsumit.....	12
Shpjegime metodologjike .....	13

## Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për muajin Dhjetor 2021

Inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte 0,5% në muajin dhjetor 2021. Norma vjetore e inflacionit e matur në muajin dhjetor 2021 me muajin dhjetor 2020 ishte 6,7%. Ndërsa norma mesatare vjetore e inflacionit për vitin 2021 3,4%.

### Dhjetor 2021 / Nëntor 2021 0,5%

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0,5% në muajin dhjetor 2021 krahasuar me muajin nëntor 2021. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: buka dhe drithërat (0,9%), mishi (1,1%), vajrat dhe yndyrat ushqimore (2,4%), perimet (4,2%), kafja, çaji dhe kakao (2,0%), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (1,0%), duhani (2,9%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (2,1%), blerja e automjeteve (0,5%), shërbimet hoteliere (1,5%), kujdesi personal (1,1%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,7 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te nëngrupet e COICOP-it: pemët (-2,7%), veshje (-1,6%), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-2,8%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,2 për qind në IHÇK-it

### Dhjetor 2021 / Dhjetor 2020 6,7%

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 6,7 për qind në muajin dhjetor 2021 krahasuar me muajin dhjetor 2020. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te nëngrupet e COICOP-it: buka dhe drithërat (14,4%), mishi (6,2%), qumështi, djathi dhe vezët (6,8%), vajrat dhe yndyrat ushqimore (32,7%), perimet (11,5%), sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat (9,4%), prodhime të ndryshme ushqimore salca, erëza kripë, ushqim për fëmijë etj. (5,4%), kafja, çaji dhe kakao (10,7%), ujë, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (2,3%), pijet alkoolike (3,2%), duhani (5,8%), këpucë (3,4%), mirëmbajtja dhe rregullimi i vendbanimit (3,7%), gazi (21,6%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (13,3%), mobilje dhe orendi, qilima dhe mbulesa të tjera dyshemeje (2,8%), pajisje shtëpiake (5,6%), veglat dhe pajisjet për shtëpi dhe kopsht (4,3%), produktet farmaceutike (3,3%), blerja e automjeteve (5,6%), pjesë këmbimi dhe pajisje shtesë për pajisjet e transportit personal (4,8%), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (28,1%), mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve personale të transportit (5,7%), shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit (9,9%), pajisjet audio-vizuale, fotografike për përpunimin e informative (2,9%), gjërat dhe pajisjet tjera rekreative, kopshtet dhe manaret (2,4%), gazetatat, librat dhe materialet për zyra (1,9%), shërbimet hoteliere (6,5%), kujdesi personal (3,1%), gjërat personale (1,9%), shërbimet financiare (6,0%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 6,8 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te nëngrupi i COICOP-it: pemët (-3,5%), me një ndikim prej -0,1 për qind në IHÇK-it

### Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për vitin 2021 3,4%

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit në vend në vitin 2021 ishte më i lartë në një mesatare prej 3,4 për qind krahasuar me vitin 2020. Ngritje e indeksit të çmimeve të konsumit gjatë vitit 2021 është vërejtur te nëngrupet e COICOP-it: buka dhe drithërat (4,3%), mishi (1,4%), qumështi, djathi dhe vezët (3,8%), vajrat dhe yndyrat (22,9%), perimet (4,1%), sheqeri dhe ëmbëlsirat (2,2%), kafja, çaji dhe kakao (2,4%), ujë, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (0,9%), pijet alkoolike (2,7%), duhani (3,7%), gazi (8,7%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (5,9%), mobilje dhe orendi, qilima dhe mbulesa të tjera dyshemeje (1,4%), pajisje shtëpiake (3,1%), produktet farmaceutike (2,3%),

---

blerja e automjeteve (1,3%), pjesë këmbimi dhe pajisje shtesë për pajisjet e transportit personal (1,7%), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (17,6%), mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve personale të transportit (5,3%), shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit (4,1%), shërbimet për transport (2,0%), shërbimet telefonike dhe të telefaksit (18,4%), pajisjet audio-vizuale, fotografike për përpunimin e informative (2,7%), pushime të organizuara (4,3%), shërbimet hoteliere (1,8%), kujdesi personal (1,5%), shërbimet financiare (4,7%)”, me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 3,7 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit gjatë vitit 2021 është vërejtur te nëngrupet e COICOP-it: pemët (-9,3%), energjia elektrike (-4,3%) për arsye se në periudhën janar - maj 2021 ishte për 0,0061 cent për 1kwh më e lirë sipas **Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike Covid -19 Nr. 07/L-016 neni 15**, me një ndikim të përbashkët prej -0.3 për qind në IHÇK-it.

Për më shumë detaje në publikimin vjetor të IHÇK-it për vitin 2021 me 27 Maj 2022.

**Tab. 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 - Dhjetor 2021 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje**

Muaji\Viti	Indeksi (2015 = 100)	Inflacioni mujor %	Inflacioni vjetor %
Jan - 2010	88.0	0.6	0.7
Shk - 2010	88.2	0.2	1.1
Mar - 2010	88.1	-0.1	0.8
Pri - 2010	87.2	-1.0	1.6
Maj - 2010	87.5	0.3	2.2
Qer - 2010	87.6	0.1	2.2
Korr - 2010	87.9	0.3	2.7
Gush - 2010	90.5	3.0	6.0
Shtat - 2010	90.8	0.3	6.0
Teto - 2010	91.9	1.2	6.0
Nën - 2010	92.3	0.4	6.2
Dhje - 2010	93.2	1.0	6.5
<b>Mesatarja vjetore 2010</b>	<b>89.4</b>	<b>:</b>	<b>3.5</b>
Jan - 2011	94.5	1.4	7.4
Shk - 2011	96.5	2.1	9.4
Mar - 2011	97.6	1.1	10.8
Pri - 2011	96.5	-1.1	10.7
Maj - 2011	96.5	0.0	10.3
Qer - 2011	95.7	-0.8	9.2
Korr - 2011	95.2	-0.5	8.3
Gush - 2011	95.3	0.1	5.3
Shtat - 2011	95.1	-0.2	4.7
Teto - 2011	96.2	1.2	4.7
Nën - 2011	96.2	0.0	4.2
Dhje - 2011	96.5	0.3	3.5
<b>Mesatarja vjetore 2011</b>	<b>96.0</b>	<b>:</b>	<b>7.4</b>
Jan - 2012	97.3	0.8	3.0
Shk - 2012	98.2	0.9	1.8
Mar - 2012	98.3	0.1	0.7
Pri - 2012	97.6	-0.7	1.1
Maj - 2012	97.6	0.0	1.1
Qer - 2012	97.3	-0.3	1.7
Korr - 2012	97.3	0.0	2.2
Gush - 2012	98.3	1.0	3.1
Shtat - 2012	99.1	0.8	4.2
Teto - 2012	99.9	0.8	3.8
Nën - 2012	99.5	-0.4	3.4
Dhje - 2012	100.1	0.6	3.7
<b>Mesatarja vjetore 2012</b>	<b>98.4</b>	<b>:</b>	<b>2.5</b>
Jan - 2013	100.7	0.6	3.5
Shk - 2013	100.8	0.1	2.6
Mar - 2013	100.8	0.0	2.5
Pri - 2013	100.0	-0.8	2.5
Maj - 2013	99.7	-0.3	2.2
Qer - 2013	99.9	0.2	2.7
Korr - 2013	99.6	-0.3	2.4
Gush - 2013	99.5	-0.1	1.2
Shtat - 2013	99.3	-0.2	0.2
Teto - 2013	100.1	0.8	0.2
Nën - 2013	100.3	0.2	0.8
Dhje - 2013	100.6	0.3	0.5
<b>Mesatarja vjetore 2013</b>	<b>100.1</b>	<b>:</b>	<b>1.7</b>



**Tab. 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 - Dhjetor 2021 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje (vazhdim)**

Muaji\Viti	Indeksi (2015 = 100)	Inflacioni mujor %	Inflacioni vjetor %
Jan - 2014	100.9	0.3	0.2
Shk - 2014	100.9	0.0	0.1
Mar - 2014	101.1	0.2	0.3
Pri - 2014	100.3	-0.8	0.3
Maj - 2014	100.2	-0.1	0.5
Qer - 2014	100.3	0.1	0.4
Korr - 2014	100.4	0.1	0.8
Gush - 2014	100.4	0.0	0.9
Shtat - 2014	100.6	0.2	1.3
Teto - 2014	100.7	0.1	0.6
Nën - 2014	100.4	-0.3	0.1
Dhje - 2014	100.2	-0.2	-0.4
<b>Mesatarja vjetore 2014</b>	<b>100.5</b>	<b>:</b>	<b>0.4</b>
Jan - 2015	100.3	0.1	-0.6
Shk - 2015	100.6	0.3	-0.3
Mar - 2015	100.7	0.1	-0.4
Pri - 2015	99.9	-0.8	-0.4
Maj - 2015	99.7	-0.1	-0.5
Qer - 2015	99.9	0.1	-0.4
Korr - 2015	99.6	-0.2	-0.8
Gush - 2015	99.7	0.1	-0.7
Shtat - 2015	99.4	-0.3	-1.2
Teto - 2015	100.0	0.6	-0.7
Nën - 2015	100.1	0.1	-0.3
Dhje - 2015	100.0	0.0	-0.2
<b>Mesatarja vjetore 2015</b>	<b>100.0</b>	<b>:</b>	<b>-0.5</b>
Jan - 2016	100.5	0.4	0.1
Shk - 2016	100.7	0.2	0.0
Mar - 2016	100.8	0.1	0.1
Pri - 2016	99.8	-1.0	-0.1
Maj - 2016	99.6	-0.2	-0.1
Qer - 2016	99.6	-0.1	-0.3
Korr - 2016	99.6	0.0	0.0
Gush - 2016	99.8	0.2	0.0
Shtat - 2016	99.9	0.2	0.6
Teto - 2016	100.9	0.9	0.9
Nën - 2016	101.0	0.1	0.9
Dhje - 2016	101.3	0.4	1.3
<b>Mesatarja vjetore 2016</b>	<b>100.3</b>	<b>:</b>	<b>0.3</b>
Jan - 2017	102.2	0.8	1.7
Shk - 2017	102.3	0.2	1.7
Mar - 2017	102.3	-0.1	1.5
Pri - 2017	102.0	-0.3	2.2
Maj - 2017	101.2	-0.8	1.5
Qer - 2017	101.5	0.3	1.9
Korr - 2017	101.3	-0.2	1.7
Gush - 2017	101.5	0.2	1.7
Shtat - 2017	101.6	0.1	1.7
Teto - 2017	101.8	0.2	0.9
Nën - 2017	101.8	0.1	0.9
Dhje - 2017	101.8	0.0	0.5
<b>Mesatarja vjetore 2017</b>	<b>101.8</b>	<b>:</b>	<b>1.5</b>

**Tab. 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 - Dhjetor 2021 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje (vazhdim)**

Muaji\Viti	Indeksi (2015 = 100)	Inflacioni mujor %	Inflacioni vjetor %
Jan - 2018	102.0	0.2	-0.2
Shk - 2018	102.3	0.3	0.0
Mar - 2018	102.4	0.1	0.1
Pri - 2018	102.4	0.0	0.4
Maj - 2018	102.2	-0.2	1.0
Qer - 2018	102.3	0.1	0.8
Korr - 2018	102.5	0.2	1.2
Gush - 2018	103.0	0.4	1.5
Shtat - 2018	103.1	0.1	1.4
Teto - 2018	103.3	0.2	1.5
Nën - 2018	103.9	0.7	2.1
Dhje - 2018	104.8	0.8	2.9
<b>Mesatarja vjetore 2018</b>	<b>102.8</b>	<b>:</b>	<b>1.1</b>
Jan - 2019	105.2	0.4	3.1
Shk - 2019	105.6	0.4	3.2
Mar - 2019	105.7	0.1	3.3
Pri - 2019	105.9	0.1	3.4
Maj - 2019	105.7	-0.2	3.4
Qer - 2019	105.3	-0.3	3.0
Korr - 2019	105.2	-0.1	2.6
Gush - 2019	105.7	0.5	2.7
Shtat - 2019	105.6	-0.1	2.4
Teto - 2019	105.5	0.0	2.2
Nën - 2019	105.7	0.2	1.7
Dhje - 2019	106.0	0.2	1.2
<b>Mesatarja vjetore 2019</b>	<b>105.6</b>	<b>:</b>	<b>2.7</b>
Jan - 2020	106.8	0.8	1.5
Shk - 2020	106.6	-0.2	1.0
Mar - 2020	106.5	-0.1	0.7
Pri - 2020	106.2	-0.3	0.3
Maj - 2020	105.9	-0.3	0.2
Qer - 2020	105.4	-0.4	0.1
Korr - 2020	105.1	-0.3	-0.1
Gush - 2020	105.2	0.1	-0.5
Shtat - 2020	105.1	-0.1	-0.4
Teto - 2020	105.3	0.2	-0.2
Nën - 2020	105.4	0.1	-0.3
Dhje - 2020	106.1	0.6	0.1
<b>Mesatarja vjetore 2020</b>	<b>105.8</b>	<b>:</b>	<b>0.2</b>
Jan - 2021	106.6	0.5	-0.2
Shk - 2021	107.4	0.7	0.7
Mar - 2021	107.8	0.4	1.2
Pri - 2021	108.2	0.3	1.9
Maj - 2021	107.9	-0.2	2.0
Qer - 2021	107.9	0.0	2.4
Korr - 2021	108.8	0.8	3.5
Gush - 2021	110.1	1.2	4.7
Shtat - 2021	110.2	0.1	4.9
Teto - 2021	111.3	1.0	5.7
Nën - 2021	112.7	1.2	6.9
Dhje - 2021	113.2	0.5	6.7
<b>Mesatarja vjetore 2021</b>	<b>109.3</b>	<b>:</b>	<b>3.4</b>



**Graf. 1: Indeksi i harmonizuar vjetor i çmimeve të konsumit sipas viteve 2010 - 2021 (2015=100)****Graf. 2: Normat vjetore dhe mujore të inflacionit në përqindje të matura nga IHÇK-it**

**Tab. 2: Peshat, IHÇK-it për muajin Dhjetor 2021 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it**

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2021 në %	XII - 2021 2015=100	XII - 2021 XI - 2021	XII - 2021 XII - 2020	Indeksi mesatar vjetor 2021, 2015=100	2021 2020
<b>00</b>	<b>Gjithsej IHÇK</b>	<b>1000.0</b>	<b>113.2</b>	<b>0.5</b>	<b>6.7</b>	<b>109.3</b>	<b>3.4</b>
<b>01</b>	<b>Ushqimi dhe pijet joalkoolike</b>	<b>398.7</b>	<b>118.1</b>	<b>1.0</b>	<b>8.1</b>	<b>112.7</b>	<b>2.4</b>
<b>01.1</b>	<b>Ushqimi</b>	<b>335.5</b>	<b>119.3</b>	<b>1.0</b>	<b>8.9</b>	<b>113.4</b>	<b>2.6</b>
01.1.1	Buka dhe drithërat	87.7	131.9	0.9	14.4	119.5	4.3
01.1.2	Mishi	97.8	117.5	1.1	6.2	112.3	1.4
01.1.3	Peshqit	3.4	112.1	1.2	2.4	110.0	0.4
01.1.4	Qumështi, djathi dhe vezët	59.2	119.8	0.0	6.8	112.3	3.8
01.1.5	Vajrat dhe yndyrnat	5.7	148.8	2.4	32.7	132.4	22.9
01.1.6	Pemët	23.0	79.8	-2.7	-3.5	92.4	-9.3
01.1.7	Perimet	36.8	110.9	4.2	11.5	107.5	4.1
01.1.8	Sheqeri, reçeli, mjalta, çokollata dhe ëmbëlsirat	12.7	121.3	0.8	9.4	113.3	2.2
01.1.9	Prodhimet ushqimore	9.2	111.7	1.6	5.4	107.7	1.1
<b>01.2</b>	<b>Pijet joalkoolike</b>	<b>63.2</b>	<b>113.1</b>	<b>1.2</b>	<b>3.9</b>	<b>110.0</b>	<b>1.2</b>
01.2.1	Kafja, çaji dhe kakao	12.0	141.4	2.0	10.7	130.0	2.4
01.2.2	Uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet	51.2	106.3	1.0	2.3	104.9	0.9
<b>02</b>	<b>Pijet alkoolike, duhani</b>	<b>64.2</b>	<b>123.5</b>	<b>1.3</b>	<b>4.7</b>	<b>121.6</b>	<b>3.3</b>
02.1	Pijet alkoolike	28.5	112.8	-0.8	3.2	113.1	2.7
02.2	Duhani	35.7	132.7	2.9	5.8	128.7	3.7
<b>03</b>	<b>Veshje dhe këpucë</b>	<b>41.7</b>	<b>100.1</b>	<b>-0.9</b>	<b>0.7</b>	<b>101.8</b>	<b>-0.5</b>
03.1	Veshje	31.7	98.2	-1.6	-0.2	100.9	-0.5
03.2	Këpucë	10.0	106.2	1.2	3.4	104.4	-0.6
<b>04</b>	<b>Strehimi , uji, energji elektrike, gazi dhe lëndë djegëse të tjera</b>	<b>77.5</b>	<b>105.7</b>	<b>0.7</b>	<b>4.8</b>	<b>100.4</b>	<b>0.7</b>
04.1	Pagesa aktuale për banim	5.3	97.5	0.1	0.0	97.5	0.0
04.3	Mirëmbajtja dhe rregullimi i vendbanimit	8.9	109.1	0.3	3.7	106.7	1.4
04.4	Furnizimi me ujë dhe shërbimet e ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin	12.7	99.5	0.0	0.1	99.5	0.8
<b>04.5</b>	<b>Energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera</b>	<b>50.6</b>	<b>105.9</b>	<b>1.0</b>	<b>6.7</b>	<b>98.2</b>	<b>0.6</b>
04.5.1	Energjia elektrike	26.4	89.8	0.0	0.5	85.7	-4.3
04.5.2	Gaz	4.1	125.0	2.6	21.6	113.0	8.7
04.5.4	Lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj.	17.9	136.6	2.1	13.3	121.4	5.9
04.5.5	Energjia e termike	2.2	91.8	0.0	0.0	91.8	0.0
<b>05</b>	<b>Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë</b>	<b>77.4</b>	<b>105.9</b>	<b>0.6</b>	<b>2.9</b>	<b>103.9</b>	<b>1.0</b>
05.1	Mobilje dhe orendi, qilimat dhe mbulesa dysHEMEJE të tjera	17.3	103.7	-0.3	2.8	102.2	1.4
05.2	Tekstile shtëpiake	3.5	100.6	1.0	2.7	98.8	0.7
05.3	Pajisje shtëpiake	13.9	106.1	-0.1	5.6	103.2	3.1
05.4	Qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës	13.8	105.7	1.6	1.3	104.1	-1.1
05.5	Veglat dhe pajisjet për shtëpi dhe kopsht	13.8	109.4	1.1	4.3	106.5	1.8
05.6	Mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake	15.1	106.6	0.7	0.6	105.3	-0.4

**Tab. 2: Peshat, IHÇK-it për muajin Dhjetor 2021 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it (vazhdim)**

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2021 në %	XII - 2021 2015=100	XII - 2021 XI - 2021	XII - 2021 XII - 2020	Indeksi mesatar vjetor 2021 2015=100	2021 2020
<b>06</b>	<b>Shëndetësia</b>	<b>20.9</b>	<b>110.3</b>	<b>0.1</b>	<b>1.2</b>	<b>109.5</b>	<b>1.1</b>
06.1	Produkte mjekësore, aparaturë dhe pajisje	11.8	110.8	0.1	2.0	109.4	1.6
06.1.1	Produktet farmaceutike	8.9	111.3	0.2	3.3	109.0	2.3
06.1.2	Produkte të tjera mjekësore	0.8	106.0	0.0	-1.0	106.1	-0.1
06.1.3	Pajisjet terapeutike	2.1	111.5	0.0	-2.3	113.6	-0.4
06.2	Shërbimet ambulatore	8.1	110.8	0.0	0.1	110.8	0.5
06.3	Shërbimet spitalore	1.0	100.0	0.0	0.0	100.0	0.0
<b>07</b>	<b>Transporti</b>	<b>157.9</b>	<b>112.9</b>	<b>-1.1</b>	<b>13.6</b>	<b>107.6</b>	<b>8.1</b>
07.1	Blerja e automjeteve	59.7	106.1	0.5	5.6	102.2	1.3
07.2	Përdorimi i pajisjeve për transportin personal	79.4	116.9	-2.1	22.8	109.8	14.2
07.2.1	Pjesë këmbimi dhe pajisje shtesë për pajisjet e transportit personal	10.8	104.3	0.8	4.8	101.5	1.7
07.2.2	Karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal	59.9	117.3	-2.8	28.1	109.3	17.6
07.2.3	Mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve personale të transportit	3.3	113.8	0.0	5.7	111.6	5.3
07.2.4	Shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit	5.4	137.1	0.0	9.9	129.9	4.1
07.3	Shërbimet për transport	18.8	109.7	-0.9	-0.1	108.2	2.0
<b>08</b>	<b>Mjetet e komunikimit</b>	<b>33.2</b>	<b>115.2</b>	<b>0.1</b>	<b>0.2</b>	<b>114.8</b>	<b>14.8</b>
08.1	Shërbimet postare	2.3	104.6	0.0	0.0	104.6	0.0
08.2	Pajisjet telefonike dhe të telefaksit	3.8	84.4	1.1	0.9	82.6	-4.0
08.3	Shërbimet telefonike dhe të telefaksit	27.1	121.3	0.0	0.2	121.1	18.4
<b>09</b>	<b>Rekrecioni dhe kultura</b>	<b>42.2</b>	<b>98.3</b>	<b>0.5</b>	<b>1.6</b>	<b>98.3</b>	<b>1.5</b>
09.1	Pajisjet audio-vizuale, fotografike për përpunimin e informatave	10.4	87.1	-0.4	2.9	86.8	2.7
09.2	Pajisjet tjera të qëndrueshme për rekreacion dhe kulturë	1.5	99.9	-1.2	-1.3	100.8	-0.4
09.3	Gjërat dhe pajisjet tjera rekreative, kopshtet dhe manaret	7.5	103.8	2.1	2.4	101.9	-0.1
09.4	Shërbimet rekreative dhe kulturore	6.5	102.1	0.8	0.6	101.5	-0.1
09.5	Gazetat, librat dhe materialet për zyra	10.5	101.5	0.6	1.9	100.7	0.9
09.6	Pushime të organizuara	5.8	102.3	0.0	-0.7	106.7	4.3
<b>10</b>	<b>Arsimi</b>	<b>9.9</b>	<b>101.8</b>	<b>0.1</b>	<b>1.7</b>	<b>101.3</b>	<b>1.3</b>
<b>11</b>	<b>Restorantet dhe hotelet</b>	<b>30.7</b>	<b>113.6</b>	<b>1.4</b>	<b>5.9</b>	<b>109.4</b>	<b>1.8</b>
11.1	Shërbimet hoteliere	27.6	114.2	1.5	6.5	109.7	1.9
11.2	Shërbimet për strehim	3.1	110.4	0.0	1.0	109.8	0.8
<b>12</b>	<b>Mallrat dhe shërbimet e ndryshme</b>	<b>45.7</b>	<b>110.1</b>	<b>0.5</b>	<b>2.7</b>	<b>108.7</b>	<b>1.6</b>
12.1	Kujdesi personal	16.8	107.5	1.1	3.1	105.5	1.5
12.3	Gjërat personale	8.8	110.8	0.4	1.9	109.0	0.7
12.4	Mbrojtja sociale	0.8	109.7	0.0	0.0	109.6	0.5
12.5	Sigurimet	7.7	122.2	0.1	-0.2	122.2	-0.2
12.6	Shërbimet financiare	9.0	107.1	0.0	6.0	105.8	4.7
12.7	Shërbimet tjera	2.6	99.4	0.0	0.0	99.4	-0.1

Tab. 3: Çmimi mesatar në euro për disa artikuj dhe shërbime të konsumit

Kodi	Artikujt	Njësia matëse	XII 2020	XI 2021	XII 2021
101	Oriz	1 kg	1.43	1.44	1.44
102	Miell gruri	1 kg	0.50	0.64	0.65
103	Bukë e bardhë	500 gr	0.35	0.42	0.42
111	Mish gjedhi pa eshtra	1 kg	6.71	6.91	7.01
112	Mish viçi	1 kg	7.58	7.94	7.98
114	Mish pule	1 kg	2.63	2.86	2.87
131	Qumësht (Tetrapak)	1 lit	0.87	0.93	0.92
133	Jogurt	1 lit	0.81	0.93	0.93
137	Vezë	30 copë	3.01	3.09	3.06
141	Vaj ushqimor luledielli	1 lit	1.15	1.64	1.69
151	Mollë	1 kg	0.63	0.67	0.61
152	Dardhë	1 kg	1.46	1.42	1.39
153	Banane	1 kg	1.03	1.15	1.15
155	Limon	1 kg	1.15	1.05	1.00
161	Patate	1 kg	0.47	0.62	0.63
162	Domate	1 kg	0.85	0.92	0.91
163	Fasule	1 kg	2.54	2.65	2.64
167	Speca të pa djegës	1 kg	1.39	1.16	1.41
175	Sheqer	1 kg	0.70	0.86	0.87
192	Kafe e bluar	1 kg	9.38	10.66	10.88
193	Çaj	1 kg	7.97	7.86	8.02
195/1	Uji natyral pa gaz	1.5 lit	0.30	0.30	0.32
196	Coca cola	2 lit	1.29	1.30	1.31
197	Lëng pemësh	1 lit	0.89	0.90	0.90
204	Birrë	0.5 lit	0.66	0.66	0.66
216	Cigare - Ronson	1 pako	1.75	1.78	1.87
217	Cigare - Marlboro	1 pako	2.70	2.80	2.87
416	Energja elektrike (Pa kosto fikse)	1 kwh	0.06	0.06	0.06
418	Dru zjarri	1 m <sup>3</sup>	40.28	45.67	46.61
701	Benzin	1 lit	0.94	1.28	1.24
702	Dizel	1 lit	0.92	1.25	1.22

## Shpjegime metodologjike

### Përkufizime

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) i Kosovës, i prodhuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), është i përpiluar sipas metodave të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK). Eurostati e ka definuar IHÇK si standard Evropian për indeksin e çmimeve të konsumit. Indeksi i kalkuluar dhe rezultatet e tyre prezantohen përmes Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP), klasifikim ky ndërkombëtarë i cili klasifikon konsumin në Divizione, Grupe dhe Klasa artikujsh. Sipas COICOP-it, ASK ka ndarë 91 klasa konsumi të definuar (në nivel 4-shifror) me tutje në 420 produkte (agregat elementarë). ASK ka përcaktuar peshë për çdo element agregues dhe çdo muaj grumbullon çmime për secilin agregat elementarë.

Çdo muaj IHÇK kalkulohet në dy hapa:

1. Indekset elementarë (treguesit për agregat elementarë) llogariten nga çmimet e grumbulluara duke përdorur formulën e mesatares gjeometrike të papeshuar (të Jevon-it).
2. Indekset e nivelit më të lartë, dukë përfshirë vetë IHÇK, llogariten dukë nxjerrë mesataren e indekseve elementarë përmes formulës së mesatares aritmetike të peshuar (tipi i Laspeyres).

Peshat elementare të agreguara janë bazuar në vlerësimet e shpenzimeve të konsumit vjetor. ASK për 91 klasa konsumi bën vlerësimin e shpenzimeve të konsumit vjetor nga Anketa e Buxhetit Familjar (ABF) dhe Llogaritë Kombëtare (LLK), peshat brenda klasave të konsumit vijnë nga burimet e brendshme të ASK-së. Peshat specifike nga janari 2013, ishin të bazuara në vlerësimet e të dhënave të Anketës së Buxhetit Familjar dhe Llogaritë Kombëtare që i referohen vitit 2012. Nga janari i vitit 2015 peshat specifike të rifreskuara bazohen në të dhënat e Llogaritë Kombëtare dhe nga Anketa e Buxhetit Familjar të vitit 2013. Nga janari i vitit 2016 peshat specifike për artikuj dhe shërbime të harmonizuara sipas E-coicop (rekomandime nga Eurostatit) bazohen në të dhënat e Llogaritë Kombëtare dhe nga Anketa e Buxhetit Familjar të vitit 2014. Nga janari i vitit 2017 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogaritë Kombëtare të vitit 2015. Nga janari i vitit 2018 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogaritë Kombëtare të vitit 2016. Nga janari i vitit 2019 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogaritë Kombëtare të vitit 2017. Nga janari i vitit 2020 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogaritë Kombëtare të vitit 2018. Nga janari i vitit 2021 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogaritë Kombëtare të vitit 2019. Rifreskimi i peshave çdo vit, siguron se IHÇK reflekton trendet aktuale të konsumit.

Të gjitha blerjet monetare të bëra në vend (brenda vendit) nga sektori i ekonomive familjare definojnë si gjithsej shpenzimet e konsumit vjetor. Ky definicion përputhet me kategorinë e LLK të quajtur Konsumi Final Monetar i Ekonomive Familjare (HFMC) dhe nënkupton se peshat duhet të përfshijnë vlerën e konsumit të produkteve vetanake dhe koston e banimit nga vetë pronari.

Deri në dhjetorin e vitit 2014 peshat kanë përfshi shpenzimet vetëm për konsumatorët rezident, ndërsa nga janari i vitit 2015 përfshihen edhe shpenzimet për konsumatorët jo rezident.

Për të vlerësuar ndryshimet mujore të çmimeve, stafi i ASK mblodh çmime për një numër të artikujve specifik (shpesh të quajtur shporta e tregut) të zgjedhura si përfaqësim i agregateve elementar. Qëllimi është që të mblidhen të gjitha çmimet, pikërisht artikujve të njëjtë për çdo muaj; kurdo që një çmim nuk ka mundësi të mblidhet, atëherë procedurat e llogaritjes duhet të aplikohen me kujdes për t'u shmangur rezultatit të anueshëm.

Grumbulluesit e të dhënave pranë ASK-së, me seli në shtatë qendra rajonale (zyre rajonale statistikore), mbledhin përafërsisht mbi 6800 çmime gjatë periudhës nga data 10-20 të çdo muaji referues. Çmimet mbledhen në supermarkete, ndërmarrje shërbyese, dyqane, tregje dhe pika tjera të shitjes me pakicë në katërbëdhjetë komuna të Kosovës:

- Gjakovë
- Gjilan
- Istog
- Kaçanik
- Kamenicë
- Mitrovicë
- Rahovec
- Pejë
- Podujevë
- Prishtinë
- Prizren
- Suharekë
- Ferizaj
- Vushtrri

Stafi i zyrës qendrore të ASK-së në Prishtinë mbledh çmimet për artikuj dhe shërbime si rryma, uji, shërbimet postare dhe telekomunikacioni, për transportin ajror dhe hekurudhor .

### Indekset Elementar

Indeksi elementar për një muaj është i barabartë me indeksin e tij në muajin paraprak të shumëzuar me ndryshimin e çmimit të matur për një muaj, i llogaritur nga çmimet e grumbulluara. ASK përdor formulën e mesatares gjeometrike (apo të Jevon-it) për të llogaritur ndryshimet njëmuajore: shkalla e mesatares gjeometrike të muajit aktual në mesataren gjeometrike të çmimeve të mbledhura për muajin e kaluar.

Indeksi i agregatit elementar e për muajin m

- = Indeksi i çmimit për agregatin elementar e për muajin m
- = Indeksi i çmimit për agregatin elementar e për muajin m-1
- = Çmimi për artikullin i në muajin m
- = Çmimi për artikullin i në muajin m-1
- = Numri i çmimeve të mbledhura për agregatin elementar e

### Indekset e Nivelit më të Lartë

Në Kosovë, Indekset e IHÇK së pari llogariten në grupe (të agregateve elementare) dhe pastaj këto kombinohen për të nxjerrë IHÇK e tërësishëm.

Indekset e Nivelit të Lartë peshohen me mesataret aritmetike të indekseve elementare. Në IÇK është përdorur formula e Young-ut deri në dhjetor 2013, peshat janë pjesë e peshimit të parregulluar për shpenzime në periudhë. Që nga janari 2014 është kaluar në përdorimin e formulës së Lowe-it për kalkulimin e indeksit, me pesha të cilat janë pjesë e peshave të periudhave të shpenzimeve, e të cilat janë të azhuruara me ndryshmet e çmimeve. (Formula e Lowe-it është e përafërt me formulat aktuale të Laspeyres).

Të dy formulat, si formula e Young-ut dhe ajo e Lowe-it janë mesatare aritmetike të peshuara me pesha që janë pjesë e shpenzimeve të konsumit, dhe të dyja janë lloj i formulave të indeksit të Laspeyres. Aktualisht IHÇK përdor formulën e Lowe-it për indekse, peshat e të cilit janë pjesë e shpenzimeve gjatë

Në Kosovë, Indekset e IHÇK së pari llogariten në grupe (të agregateve elementare) dhe pastaj këto kombinohen për të nxjerrë IHÇK e tërësishëm.

Indekset e Nivelit të Lartë peshohen me mesataret aritmetike të indekseve elementare. Në IÇK është përdorur formula e Young-ut deri në dhjetor 2013, peshat janë pjesë e peshimit të parregulluar për shpenzime në periudhë. Që nga janari 2014 është kaluar në përdorimin e formulës së Lowe-it për kalkulimin e indeksit, me pesha të cilat janë pjesë e peshave të periudhave të shpenzimeve, e të cilat janë të azhuruara me ndryshmet e çmimeve. (Formula e Lowe-it është e përafërt me formulat aktuale të Laspeyres).

Të dy formulat, si formula e Young-ut dhe ajo e Lowe-it janë mesatare aritmetike të peshuara me pesha që janë pjesë e shpenzimeve të konsumit, dhe të dyja janë lloj i formulave të indeksit të

Laspeyres. Aktualisht IHÇK përdor formulën e Lowe-it për indekse, peshat e të cilit janë pjesë e shpenzimeve gjatë periudhës së peshuar viti 2010. Peshat e reja nga të dhënat e LLK dhe ABF- vitit 2012 janë aplikuar nga janari i vitit 2014. IÇK ka kaluar në kalkulimin e indekseve me formulën Lowe-it; (peshat kanë qenë pjesë e shpenzimeve të vitit 2012 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2013. Nga janari i vitit 2015 janë aplikuar peshat specike nga të dhënat e LLK dhe ABF të vitit 2013 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2014. Nga janari i vitit 2016 peshat specifike bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) dhe nga Anketa e Buxhetit Familjar (ABF) të vitit 2014 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2015. Nga janari i vitit 2017 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2015 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2016. Nga janari i vitit 2018 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2016 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2017. Nga janari i vitit 2019 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2017 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2018. Nga janari i vitit 2020 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2018 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2019.

### Peshat e Indeksit

#### Formula e Young Peshon Agregatet Elementare brenda Grupeve

$$w_{e,g}^b = \frac{x_e^b}{\sum_{e=1}^{k_g} x_e^b} \quad \sum_{e=1}^{k_g} w_{e,g} = 1$$

$w_{e,g}^b$  = Pesha për agregat elementarë **e** brenda grupit **g** në periudhën peshuese **b**

$x_e^b$  = shpenzimet për agregatin elementar **e** në periudhën peshuese **b** (Aktualisht **b** = 2012)

$k_g$  = Numri i agregateve elementare në grupin **g**

#### Formula e Young peshon grupet brenda IHÇK së tërësishëm

$$w_g^b = \frac{\sum_{e=1}^{k_g} x_e^b}{\sum_{g=1}^h \sum_{e=1}^{k_g} x_e^b} \quad \sum_{g=1}^h w_{e,g} = 1$$

$w_g^b$  = Pesha për grupin **g** në periudhën peshuese **b**

$h$  = Numri i grupeve në ICK

#### Formula e Lowe-it peshon agregatet elementarë brenda grupeve

$$w_{e,g}^b = \frac{x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v}}{\sum_{e=1}^{k_g} (x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v})} \quad \sum_{e=1}^{k_g} w_{e,g} = 1$$

$w_{e,g}^b$  = Pesha për agregat elementar **e** brenda grupit **g** në periudhën peshuese **b**  
(Në përdorim nga Janari 2014, **b** = 2012)

$a_e^{b \rightarrow v}$  = faktor rregullues i peshave për agregatet elementar **e**

$$a_e^{b \rightarrow v} = I_e^v / \frac{1}{12} \left( \sum_{m=Jan}^{Dec} I_e^{m/b} \right)$$

$I_e^v$  = Indeksi i çmimit për agregate elementar **e** për muajin **v**

(Në përdorim nga Janari 2014, **v** = Dhjetor

2013)

$I_e^{m/b}$  = Indeksi i çmimeve për agregat elementarë **e** në muajin **m** në vitin **b**

**Formula e Lowe** peshon grupet brenda IHÇK së tërësishëm

$$w_g^b = \frac{\sum_{e=1}^{k_g} (x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v})}{\sum_{g=1}^h \sum_{e=1}^{k_g} (x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v})} \quad \sum_{g=1}^h w_{e,g} = 1$$

**Indekset për Grupet e niveleve më të larta**

$$I_g^m = \sum_{e=1}^{k_g} w_{e,g}^b * I_e^m \quad I_e^0 = 100$$

Për shumicën e artikujve periudha **0** është Maj 2002 , por kjo periudhë ndryshon për sipas inkuadrimit të artikujve të përfshirë më vonë

## IHÇK i tërësishëm

IHÇK i tërësishëm është një mesatare aritmetike e peshuar e indekseve të grupeve. Në IHÇK është përdor formula e *Young-it*, por që nga Janari i vitit 2014 është kaluar në përdorimin e formulës së Lowe-it.

Për shkak se nëngrupet kanë baza të ndryshme indeksesh (shumica kanë për bazë Maj 2002=100, por grupet e shtuara më vonë kanë bazë tjetër, nga janari i vitit 2016 idenkset janë të kaktulura me vitin bazë 2015=100), indekset e grupeve duhet të ribazohen në një periudhë të përbashkët, që është muaji **v** (muaji paraprak para së të vihen në përdorim peshat e reja).

$$HICP^m = HICP^v \times \sum_{\xi=1}^h w_{\xi}^b \times \frac{I_{\xi}^m}{I_{\xi}^v} \quad HICP^0 = 100$$

$HICP^m$  = Indeksi i harmonizuar i çmimit të konsumit për muajin **m**

**v** = muaji paraprak para së të përdoren peshat e reja (Aktualisht **v** = Dhjetor 2020)



- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129  
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>
- © : Agjencia e Statistikave të Kosovës,
- Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.